



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosova – Republic of Kosovo
MAMUŠA BELEDİYESİ-KOMUNA E MAMUSHËS-OPŠTINA MAMUŠA- MUNICIPAL OF MAMUSA

Referenca: 626/19/010/236

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Menaxherit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

Operatori Ekonomik **"TRIANGLE" SH.P.K., rr.Brigada 123, Suharekë**, me numër të biznesit: **810048167**, selia në Suharekë të cilin e përfaqëson z.Arian Bytyçi, në cilesinë e Drejtorit të Operatorit Ekonomik (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbime si më poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

"MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE NDËRTIMORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS"

Numri i Prokurimit: **626-19-1844-2-3-6**

Neni 1 Lënda: Lënda e kësaj Kontrate është mbikëqyrja e projekteve ndërtimore në Komunën e Mamushës e cila ka të bëjë me mbikëqyrjen e projekteve të ndërtimit të ulët, ndërtimit të lartë dhe ndërtimit të rrjetit elektrik.

Artikulli	PËRSHKRIMI	Sasia e përafërt e projekteve	Vlera e përafërt
1	Mbikëqyrja e projekteve të infrastrukturës rrugore (kubëza, asfalt, shtruarja e rrugëve me zhavorr etj.)	4	260,000.00
2	Mbikëqyrja e projekteve të mureve rezistues me betonarme dhe urave.	3	180,000.00
3	Mbikëqyrja e projekteve të objekteve ndërtimore që do të ndërtohen (objekte shëndetësore, shkolla, palestria si dhe objekte tjera publiko-shtetërore)	3	65,000.00
4	Mbikëqyrja e kanalizimeve, kanaleve të hapura, ujësjellësit etj.	2	30,000.00
5	Mbikëqyrja e rregullimit të ambientit të jashtëm (parqet, sheshet, lumenjtë etj).	5	105,000.00
6	Mbikëqyrja e rregullimit të rrjetit elektrik dhe ndriçimit publik.	2	70,000.00
7	Mbikëqyrja e objekteve ndërtimore që do të rinovohen (objekte shëndetësore, shkolla, palestria si dhe objekte tjera publiko-shtetërore)	3	80,000.00
8	Mbikëqyrja e objekteve ndërtimore që do të financohen nga donatorët e jashtëm dhe Qeveria e Kosovës	2	400,000.00
9	Mbikëqyrja e objekteve infrastrukturore rrugore që do të financohen nga donatorët e jashtëm dhe Qeveria e Kosovës	3	400,000.00

1.2 Kontrata do të hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të sajë nga ana e të dy palëve, ndërsa do të përfundoj në afat prej 12 muaj nga data e nënshkrimit ose me arritje të vlerës totale të kontratës.

1.3 Afati kohor i performances – Operatori Ekonomik do të filloj ti kryej shërbimet në bazë të kërkesave të Menaxherit të Kontratës në afatin sa më të shkurtër kohor por jo më shumë se dy ditë të punës nga marrja e urdhërit.

1.4 Vendi kryesor i realizimit është në Mamushë në vendet në të cilat do të realizohen projektet.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksion do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **796.50 €; Shtatqindë e nëntëdhjetë e gjasth Euro e pesëdhjetë Eurocent.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e certifikuar nga menexheri i kontratës në bazë të realizimi të shërbimeve për mbikëqyrje.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Operatori ekonomik fitues do të garantoj shërbimin e tij kualitativ sipas specifikacionit teknik të dosjes së tenderit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë shërbimet dhe të kontrollojë përparimin dhe cilësinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton

interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Ekonomike* në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Arian Bytyçi	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.04.2019	Data:	26.04.2019
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA




Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: “MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE NDËRTIMORE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS”

Nr. Prokurimit	626-19-1844-2-3-6
Nr. brendshëm	626-19-010-2-3-6

A	B	C	D	E	F	G
Artikulli Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Vlera e përafërt e projektit	Çmimi për njësi – DDP[1] – Përqindja e projektit (%)	Totali
1.	Mbikëqyrja e projekteve të infrastrukturës rrugore (kubëza, asfalt, shtruarja e rrugëve me zhavorr etj.)	Projekte	4	260,000.00	0.02%	52.00 €
2.	Mbikëqyrja e projekteve të mureve rezistues me betonarme dhe urave.	Projekte	3	180,000.00	0.35%	630.00 €
3.	Mbikëqyrja e projekteve të objekteve ndërtimore që do të ndërtohen (objekte shëndetësore, shkolla, palestra si dhe objekte tjera publiko-shtetërore)	Projekte	3	65,000.00	0.01%	6.50 €
4.	Mbikëqyrja e kanalizimeve, kanaleve të hapura, ujësjellësit etj.	Projekte	2	30,000.00	0.06%	18.00 €
5.	Mbikëqyrja e rregullimit të ambientit të jashtëm (parqet, sheshet, lumenjtë etj.)	Projekte	5	105,000.00	0.06%	63.00 €
6.	Mbikëqyrja e rregullimit të rrjetit elektrik dhe ndriçimit publik.	Projekte	2	70,000.00	0.01%	7.00 €
7.	Mbikëqyrja e objekteve ndërtimore që do të rinovohen (objekte shëndetësore, shkolla, palestra si dhe objekte tjera publiko-shtetërore)	Projekte	3	80,000.00	0.015%	12.00 €
8.	Mbikëqyrja e objekteve ndërtimore që do të financohen nga donatorët e jashtëm dhe Qeveria e Kosovës	Projekte	2	400,000.00	0.001%	4.00 €
9.	Mbikëqyrja e objekteve infrastrukturore rrugore që do të financohen nga donatorët e jashtëm dhe Qeveria e Kosovës	Projekte	3	400,000.00	0.001%	4.00 €
Totali i përgjithshëm						796.50 €
Duke llogaritur të gjitha taksat dhe tatimet e aplikuar						
Vërejtje: Çmimi duhet të llogaritet duke shumëzuar vlerën e përafërt të projektit me përqindjen e dhënë nga Operatori Ekonomik dhe të shënohet në total (G=E X F)						

Identifikimi i Operatorit Ekonomik	
Emri i Kompanisë	"triangle" shpk
Adresa e Plote	rr. Brigada 123 pn Suhareke
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	Arjan Bytyçi
Pozita	drejtor
Nënshkrimi	
Data	15.04.2019
Vula	



TRIANGLE
SH.P.K.
SUHAREKE

